



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.112, datë 30.10.2020

PËR
DHËNIEN E MIRATIMIT TË NËNSHKRIMIT TË AKTMARRËVESHJES SË
FINANCIMIT NDËRMJET BASHKISË DURRËS DHE SUBJEKTIT “DULE” SHPK
PËR RINDËRTIMIN E QENDRËS SHËNDETËSORE RROMANAT, NJËSIA
ADMINISTRATIVE RRASHBULL, BASHKIA DURRËS

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, VKM-së nr. 1003, datë 10.12.2010 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të komunës Rrashbull, të Qarkut të Durrësit”, VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kërkesës së protokolluar me tonën nr. 9408 prot., datë 20.07.2020 të Subjektit “DULE” shpk, Vendimit nr.600, datë 21.9.2020 “Për delegimin e kompetencave” të Zëvendëskryetarit të Bashkisë dhe Relacionit të përgatitur nga Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,


KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Dhënien e miratimit të nënshkrimit të aktmarrëveshjes së financimit ndërmjet Bashkisë Durrës dhe subjektit “DULE” shpk për rindërtimin e Qendrës Shëndetësore Rromanat, Njësia Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës.


2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve dhe Njësia Administrative Rrashbull, për vijimin e procedurave të mëtejshme në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 30.10.2020



2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 992 / prot.
11.



Durrës, më 04.11. 2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.112 datë 30.10.2020 “Për dhënien e miratimit të nënshkrimit të aktmarrëveshjes së financimit ndërmjet bashkisë Durrës dhe subjektit DULE shpk për rindërtimin e Qendrës Shëndetësore Rromanat, njësia administrative Rrashbull, bashkia Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

